

L I G J
PER PLOTESIMIN E LIGJIT PER QEVERINE E REPUBLIKES SE MAQEDONISE

Neni 1

Ne Ligjin per Qeverine e Republikes se Maqedonise ("Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006 dhe 115/2007), pas nenit 40-v shtohet neni i ri 40-g si vijon:

"Neni 40-g

(1) Per kryerjen e puneve te lidhura me zhvillimin e shoqerise informatike, si dhe per kryerjen e puneve te tjera profesionale nga kjo fushe, themelohet Sekretariat per shoqeri informatike.

(2) Sekretariati per shoqeri informatike i kryen punet te cilat kane te bejne me percaktimin e mekanizmave per sigurimin dhe menaxhimin me mjetet per financimin e zhvillimit te shoqerise informatike; evidencen, koordinimin dhe percjelljen e implementimit te projekteve te miratuara per zhvillimin e shoqerise informatike ne Republiken e Maqedonise; koordinimin dhe rekomandimet per implementimin e sistemeve informative ne administraten shteterore te Republikes se Maqedonise; krijimin dhe mbajtjen e evidencen e harduerit ne dispozicion, softuerit, pajisjes telekomunikative dhe pajisjes tjeter informatike dhe licencave ne suazat e administrates shteterore; krijimin dhe mbajtjen e bazes qendrore te diturise me qasje te sektoreve per informatike te administrates shteterore; dhenies se rekomandimeve, orientimeve dhe dokumenteve te tjera strategjike dhe operative ne nivel qendror; propozimeve per lidhjen e marreveshjeve me partnere strategjike; dhenien e orientimeve per perpunim operativ dhe arkivimin e te dhenave dhe informatave; koordinimin e aktiviteteve te cilat kryhen nga ana e sektoreve per informatike nga ana e sektoreve per informatike ne organet e administrates shteterore; koordinimin, menaxhimin dhe zhvillimin e rrjetit te integruar dhe te sigurt informatik per nevojat e administrates shteterore dhe publike; planifikimin, zbatimin dhe zhvillimin e rrjetit elektronik-komunikativ per lidhjen e te gjithave institucioneve publike; kujdesin per pergatitjen dhe ngritjen e vetedijes dhe edukimit publik per rendesine e zhvillimit te shoqerise informatike dhe per shfrytezimin e te fryteve; perpunimin e materialeve edukative dhe promovuese per shfrytezimin e sherbimeve elektronike; percjelljen, incizimin dhe zbatimin e standardeve nderkombetare ne organet e administrates shteterore ne fushen e informatikes dhe telekomunikacioneve, aspekteve te sigurise dhe zhvillimit te infrastruktures; vendosjen, zhvillimin dhe shfrytezimin e regjistrave shteterore dhe lokale dhe bazave te te dhenave dhe lidhjes se tyre te ndersjelle dhe shkembimit te informatave ne menyre te sigurt; zhvillimin e infrastruktures informatike dhe telekomunikative dhe teknologjise se organeve te administrates shteterore; perpunimin, koordinimin dhe percjelljen e realizmit te planeve per edukimin e vazhdueshem dhe profesionalizmin e kuadrove ne sektoret per informatike; krijimin dhe zhvillimin e vazhdueshem te sistemit arsimor dhe shkencor hulumtues; percjelljen, evidentimin dhe realizimin e bashkepunimit nderkombetar teknik dhe teknologjik; dergimin ne profesionalizim jashte vendit dhe shfrytezimin e sherbimeve te eksperteve jashte vendit; dhenien e bursave, specializimin dhe arsimimin praktik ne baze te marreveshjeve; kryen edhe pune te tjera te percaktuara me kete dhe me tjeter ligj.

(3) Me Sekretariatin e shoqerise informatike udheheq anetari i Qeverise i obliguar per shoqerine informatike i cili i ka te drejtat dhe obligimet e funksionarit i cili udheheq me organin e administrates shteterore."

Neni 2

Ne nenin 42 pas fjaleve: "Sekretariati per zbatimin e Marreveshjes kornize" vendoset presje dhe shtohen fjalet: "Sekretariati per shoqeri informatike".

Neni 3

Sekretariati per shoqeri informatike, aktet per organizimin e brendshem dhe per sistematizimin e vendeve te punes ne pajtim me ligjin do t'i miratoje ne afat prej 30 ditesh prej dites se hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn ne fuqi dite e tete nga dita e shpalljes ne "Gazeten zyrtare te Republikes se Maqedonise".